

Logo
Bashkise

Bashkia Shembull

Plani i Arsimit Parauniversitar

Përmbajtja

1. Hyrje dhe konteksti	3
• Profili demografik dhe social i Bashkisë:.....	3
• Përmbledhje e politikave dhe kuadrit ligjor:.....	3
2. Përmbledhje Ekzekutive.....	3
• Qëllimi i Planit të Arsimit Parauniversitar:.....	3
• Prioritetet kryesore:.....	3
• Përmbledhje e strukturës dhe aktiviteteve të planit:	3
3. Analiza e shërbimit të Arsimit Parauniversitar	3
• Arsimi parashkollor:	3
• Arsimi bazë:.....	3
• Arsimi i mesëm i përgjithshëm:	3
• Arsimi profesional:	4
4. Objektivat dhe masat strategjike	4
• Objektivat e përgjithshme:	4
• Masat strategjike:	4
5. Planifikimi i burimeve financiare.....	4
• Burimet financiare vendore:	4
• Burime financimi të tjera:	4
6. Aktivitete dhe Projektet	4
7. Përmbledhje e investimeve kapitale:.....	5
8. Monitorimi dhe Vlerësimi	5
9. Rishikimi dhe përshtatja e planit	5
10. Raportimi dhe transparenca	5
Aneksë:.....	6
☐ Të dhëna demografike dhe statistikore –	6
☐ Lista e institucioneve arsimore –	6
☐ Kuadri ligjor dhe rregullativ –	6
☐ Plan i detahuar i investimeve kapitale –	6
☐ Indikatorët e monitorimit dhe vlerësimit –	6
☐ Buxheti i detajuar –.....	6
☐ Lista e aktorëve të përfshirë –.....	6
☐ Rezultatet e konsultimeve publike –	6

1. Hyrje dhe konteksti

- **Profili demografik dhe social i Bashkisë:**

Përshkrimi i karakteristikave demografike dhe sociale të bashkisë, përfshirë informacionin mbi numrin e fëmijëve, të rinjve dhe popullatës në moshë shkollore.

- **Përmbledhje e politikave dhe kuadrit ligjor:**

Shpjegimi i Kuadrit bazë ligjor, rregullave dhe politikave kombëtare që përcaktojnë bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësit në fushën e arsimit (parashkollor, bazë, mesëm të përgjithshëm dhe profesional) në nivel vendor, si dhe politikat e arsimit të miratuara qeveria nga bashkia.

2. Përmbledhje Ekzekutive

- **Qëllimi i Planit të Arsimit Parauniversitar:**

Përshkrimi i qëllimit të planit dhe rëndësisë së tij për zhvillimin e arsimit parauniversitar në bashki.

- **Prioritetet kryesore:**

Përcaktimi i fushave dhe aktiviteteve kyçe që do të përfshihen në plan.

- **Përmbledhje e strukturës dhe aktiviteteve të planit:**

Një pasqyrë e shpejtë e aktiviteteve dhe objektivave të planit, në mënyrë të përfshirë në fushat e arsimit parashkollor, bazë, të mesëm dhe profesional.

3. Analiza e shërbimit të Arsimit Parauniversitar

- **Arsimi parashkollor:**

Përshkrimi i strukturës aktuale të arsimit parashkollor, përfshirë kapacitetet e institucioneve arsimore, nevojat për infrastrukturë, staf dhe regjistrimin e fëmijëve, aspekte të menaxhimit, ofrimit të shërbimit dhe mjeteve mbështetëse. Gjithashtu, identifikimi i sfidave dhe mundësive për përmirësim në përputhje me standardet kombëtare apo vendore të vendosura.

- **Arsimi bazë:**

Analiza e funksioneve të bashkisë në fushën e arsimit bazë. Vlerësimi i situatës së arsimit 9-vjeçar, duke përfshirë regjistrimin e nxënësve, situatën e infrastrukturës dhe shërbimeve të nevojshme që janë përgjegjësi e bashkisë. Identifikimi i sfidave dhe mundësive për përmirësim, në raport me standardet apo objektivat vendore që synohen.

- **Arsimi i mesëm i përgjithshëm:**

Analiza e funksioneve të bashkisë në fushën e arsimit të mesëm të përgjithshëm, duke vlerësuar sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së shërbimeve mbështetëse në këtë nivel. Përcaktimi i objektivave/synimeve të matshme në përputhje me standardet kombëtare apo vendore të vendosura.

- **Arsimi profesional:**

Analiza e funksioneve të bashkisë në fushën e arsimit profesional, identifikimi i sfidave dhe mundësive për përmirësim.

4. Objektivat dhe masat strategjike

- **Objektivat e përgjithshme:**

Përcaktimi i objektivave kryesore që synon të arrijë plani i arsimit parauniversitar, si psh. Përmirësimi i strukturës menaxheriale dhe ofrimit të shërbimit, përmirësimi i kushteve të infrastrukturës, rritja e numrit të regjistrimeve dhe gjithpërfshirja, dhe përmirësimi i shërbimeve mbështetëse me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe edukimit.

- **Masat strategjike:**

Detajimi i aktiviteteve dhe masave që do të ndërmerren për të arritur këto objektiva. Këto mund të përfshijnë aktivitete për përmirësimin e kushteve infrastrukturore, përditësimin e materialeve mësimore, përmirësimin e burimeve njerëzore dhe mbështetje për fëmijët me nevoja speciale, etj.

5. Planifikimi i burimeve financiare

- **Burimet financiare vendore:**

Përcaktimi i buxhetit të nevojshëm për zbatimin e planit dhe burimet financiare bashkiake që do të përdoren për realizimin e objektivave.

- **Burime financimi të tjera:**

Identifikimi i mundësive të tjera për sigurimin e financimeve të nevojshme, përfshirë donacione, burime shtetërore dhe mundësitë e bashkëfinancimit me organizata ndërkombëtare ose donatorë.

Klasifikimi sipas burimeve

✚ **Burimet njerëzore:** Planifikimi i nevojave buxhetore për staf arsimor (parashkollor) dhe administrativ, duke përfshirë rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin profesional të mësuesve (arsimi parashkollor) dhe menaxherëve e punonjësve të shërbimit për të garantuar cilësi dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve arsimore.

✚ **Burimet materiale dhe infrastrukturore:** Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave buxhetore për përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe pajisjeve mësimore, duke përfshirë ndërtimin e shkollave, rikonstruksionin e ambienteve ekzistuese, përmirësimin e klasave dhe furnizimin me teknologji edukative moderne.

6. Aktivitete dhe Projektet

- **Aktivitetet e planit:** Detajimi i aktiviteteve që do të realizohen për secilën fushë të arsimit (parashkollor, bazë, të mesëm, dhe profesional).

- **Afatet e zbatimit:** Përcaktimi i periudhave të kohës për zbatimin e aktiviteteve, përfshirë afate të qarta dhe kontroll të avancimit.
- **Roli i aktorëve të përfshirë:** Përcaktimi i përgjegjësive për aktorët kyç që do të implementojnë aktivitete, përfshirë drejtorët e shkollave, këshillat lokalë, dhe autoritetet arsimore.
- **Detajimi i shpenzimeve:** Përcaktimi i shpenzimeve për aktivitetet e planit dhe burimet përkatëse financiare që do të përdoren për implementimin e aktiviteteve të planit.

7. Përmbledhje e investimeve kapitale:

Pasqyrimi i investimeve kapitale të planifikuara në infrastrukturën arsimore, duke përfshirë ndërtimin, rikonstruksionin dhe rehabilitimin e institucioneve arsimore, si dhe investimet në pajisje dhe materiale didaktike. Identifikimi i prioriteteve dhe nevojave për investime të reja në përputhje me objektivat strategjike të bashkisë për përmirësimin e cilësisë dhe aksesit në arsim.

8. Monitorimi dhe Vlerësimi

- **Indikatorët e performancës:** Definimi i indikatorëve të matshëm për monitorimin e progresit, siç janë nivelet e regjistrimit, përqindjet e arritjeve të nxënësve, cilësia e mësimdhënies, dhe përfitimet e të mësuarit.
- **Planifikimi i vlerësimit të progresit:** Vendosja e mekanizmave për vlerësimin e zbatimit të planit dhe ndikimin që ka në zhvillimin e arsimit në bashki. Kjo mund të përfshijë analizën e rezultateve të aktiviteteve, përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve, dhe përmirësimin e kushteve të infrastrukturës.
- **Përfshirja e aktorëve të jashtëm:** Konsultimi me ekspertë të jashtëm dhe aktorë të tjerë të interesuar për të siguruar vlerësime të pavarura dhe rekomandime për përmirësimet.

9. Rishikimi dhe përshtatja e planit

- **Procesi i rishikimit:** Planifikimi i periudhave të rishikimit të planit për të siguruar që ai të mbetet i përshtatshëm dhe i efektshëm gjatë kohës.
- **Përshtatja e masave dhe aktiviteteve:** Bazuar në rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit, përshtatja e masave dhe aktiviteteve për të përmirësuar implementimin dhe për të adresuar çdo vështirësi të hasur gjatë zbatimit të planit.

10. Raportimi dhe transparenca

- **Raportimi i progresit:** Përcaktimi i mënyrës së raporteve të rregullta për progresin e planit, përfshirë informacionin mbi realizimin e objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra.
- **Përfshirja e publikut:** Sigurimi i transparencës përmes publikimit të rezultateve të zbatimit të planit dhe mundësitë për konsultime publike për të mbledhur mendime dhe sugjerime nga qytetarët dhe komuniteti.

Anekse:

- ☐ **Të dhëna demografike dhe statistikore** – Përmbledhje e të dhënave të detajuara të përfshira në regjistrin e shërbimit: p.sh. mbi popullsinë në moshë shkollore, regjistrimet në shkolla, shifrat e frekuentimit dhe shkallën e braktisjes shkollore, etj.
- ☐ **Lista e institucioneve arsimore** – Të dhëna mbi numrin dhe llojin e institucioneve arsimore (kopshte, shkolla 9-vjeçare, gjimnaze, shkolla profesionale), kapacitetet e tyre dhe nevojat infrastrukturore.
- ☐ **Kuadri ligjor dhe rregullativ** – Përmbledhje e ligjeve, rregulloreve dhe udhëzimeve që rregullojnë arsimin parauniversitar në nivel lokal dhe kombëtar.
- ☐ **Plani i detahuar i investimeve kapitale** – Detaje mbi projektet e planifikuara për ndërtimin, rikonstruksionin ose zgjerimin e institucioneve arsimore.
- ☐ **Indikatorët e monitorimit dhe vlerësimit** – Lista e indikatorëve të matshëm për ndjekjen e progresit të planit dhe ndikimit të tij në sistemin arsimor.
- ☐ **Buxheti i detajuar** – Pasqyrimi i shpenzimeve të parashikuara për secilin komponent të planit, burimet e financimit dhe shpërndarja e fondeve.
- ☐ **Lista e aktorëve të përfshirë** – Identifikimi i institucioneve, organizatave dhe palëve të interesuara të përfshira në zbatimin dhe mbështetjen e planit.
- ☐ **Rezultatet e konsultimeve publike** – Përmbledhje e sugjerimeve dhe komenteve të marra nga komuniteti, mësuesit, prindërit dhe ekspertët gjatë procesit të hartimit të planit.